

---

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**ARTO PHARMA SHPK**

*Në Tiranë, sot në date 01 Prill 2022;*

Unë z.Marsel Zdrava i biri i Valterit-it, lindur në Elbasan më datë 06.06.1988 dhe banues në adresën Rr. Dritan Hoxha, identifikuar me kartën e identitetit me numër personal I80606093N, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Me cilësinë e ortakut të vetëm**, kam redaktuar këtë akt themelimi dhe statut, për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "ARTO PHARMA SHPK", në respektim të Kodit Civil, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, sikur vijon :

**Neni 1 - Emërtimi i Shoqërisë**

1.1 Shoqëria e emërtuar ARTO PHARMA SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

1.2 Shoqëria është themeluar sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2 - Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Dibrës, Pallatet Arlis, Kati 1 Tiranë, Shqipëri.

2.2 Shoqëria mund të hapë zyra përfaqësimi, degë dhe/ose filiale dhe/ose të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitet në vende të tjera, qoftë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e asamblesë së ortakëve.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

---



---

#### **Neni 4 - Objekti**

4.1 Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

Tregti të barnave dhe mallrave farmaceutike. Tregti të mallrave kozmetike, të kujdesit shëndetësor, mallra të ndryshëm të fushës së shëndetësisë. Kryerja e aktiviteteve ndihmëse për realizimin e qëllimit të aktivitetit kryesor

#### **Neni 5 - Kapitali**

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 1,000,000 (një milion) LEKË, i ndarë në 1 (një) kuotë, vlera e të cilave zotërohet nga Ortakët si më poshtë:

- **Marsel Zdrava**, mbajtës i 1(një) kuote, e cila përfaqëson 100% të kapitalit me vlerën 1,000,000 (një milion) LEKË;

5.2 Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin shqiptar. Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

#### **Neni 6 - Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

6.1 Në bazë të ligjeve dhe dispozitave të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme e ortakëve të Shoqërisë është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë. Ajo përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, janë detyruese për të gjithë ortakët, përfshirë ata që nuk marrin pjesë në votim dhe që votojnë kundër këtyre vendimeve, ajo mbledhet në selinë e saj apo në çdo vend tjetër .

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve si më poshtë vijon:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) miratimi i ndryshimeve të statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e anetarëve të Këshillit Administrativ/Administratorit të Vetëm si dhe përcaktimi i kompetencave dhe shpërblimit të tyre;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likujduesëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimi i shpërblimit të tyre;
- e) mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga Këshilli Administrativ/Administratori i Vetëm, përfshirë mbikëqyrjen e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatës;

---



---

g) zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatës;

h) pjestimin e kuotave, anulimin e tyre, largimin e ortakut, ndarjen e fitimit në përputhje me përqindjet e kuotave ose jo, kjo në marrëveshje me ortakët;

i) caktimin e përfaqësuesit të Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj anëtarëve të Këshillit Administrativ/Administratorit të Vetëm;

j) miratimin e riorganizimit të Shoqërisë, përfshirë bashkimin me shoqëri të tjera, ndarjen e Shoqërisë, shndërrimin e Shoqërisë si dhe prishjen e Shoqërisë;

k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë së ortakëve.

l) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji apo Statuti.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë duke patur të drejtën e votës në raport me vlerën nominale të kuotës së tij. Çdo ortak mund të përfaqësohet në vendimarrje nga një ortak tjetër, nga bashkeshorti(ja) ose nga çdo person tjetër, me kushtin që përfaqësuesit të jenë të pajisur me autorizimin për atë qëllim. Administratorët e shoqërisë nuk mund të jenë përfaqësues të ortakëve në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së ortakëve, por përfshin edhe mbledhjet me të njëjtin rend dite.

6.2 Administratori(ët) sipas gjykimit të tij të lirë ose me kërkesën e një dhe/ose më shumë ortakëve të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë dhe/ose auditit ligjor nëse ka, dhe/ose likuiduesit kanë të drejtë të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve. Në këtë rast ortakëve duhet t'iu dërgohet një njoftim me shkrim për mbledhjen me postë elektronike (email) jo më vonë se 7 ditë përpara datës së mbledhjes, i cili thekson qëllimin, vendin dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit brenda 6 muajve nga përfundimi i vitit ushtrimor.

6.3 Përveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos në mënyrë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të numrit total të votave dhe vendimet merren me shumicën e votave të ortakut pjesëmarrës.

Për të vendosur shpërndarjen e fitimit, ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, anulimin, fshirjen e kuotës, largimin e ortakut si dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të numrit total të votave. Vendimi merret me votën pro të të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë) përqind të ortakëve të pranishëm. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të vendosë për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar më lart, ajo mbledhet përsëri, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

---



---

## Neni 7 - Administrimi i Shoqërisë

7.1 Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori.

7.2 Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet. Administratori mund të rizgjidhet për të njëjtën periudhë me vendim të Ortakëve të shoqërisë.

7.3 Administrator i Shoqërisë do të jetë:

**z.Marsel Zdrava**, i biri i Valter, i datëlindjes 06.06.1988, lindur në Elbasan dhe banues në adresën: Rruga Dritan Hoxha Tiranë, identifikuar me kartën e identitetit me numër personal I80606093N.

Administratori mund të shkarkohet me vendim të ortakëve në çdo moment për arsye të justifikuara.

Administratori është personalisht përgjegjës përpara Shoqërisë dhe/ose palëve të treta për dëme të shkaktuara nga shkelja e dispozitave të këtij Statuti ose të Ligjit.

## Neni 8 - Detyrat dhe Kompetencat e Administratorit

8.1 Pasuria dhe aktiviteti tregtar i Shoqërisë do të administrohen nga Administratori, i cili ka të drejtë të ushtrojë të gjitha kompetencat që gjykon të nevojshme për realizimin e objektivit të Shoqërisë, me përjashtim të atyre që ky statut dhe ligji i ka rezervuar Ortakëve të Shoqërisë. Administratori mund të autorizojë apo emërojë me anë të prokurës persona të tretë për kryerjen e veprimtarive dhe/ose kompetencave që i përkasin Administratorëve.

8.2 Kompetencat e Administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së Shoqërisë përcaktohen por pa u kufizuar, si më poshtë vijon.

- (a) të zbatojë politikat tregtare të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- (b) të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin(et) e zbatueshëm dhe standardet kontabël;
- (c) të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
- (d) të përfaqësojë Shoqërinë kundrejt palëve të treta, entiteve publike apo private, si dhe entiteve/ose autoriteteve vendase ose të huaja;
- (e) të përgatitë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë të cilat do të miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- (f) të kryejë të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë sipas parashikimeve të ligjit në fuqi;
- (g) t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare që mund të konsiderohen me rëndësi të veçantë për Shoqërinë;
- (h) të punësojë dhe të shkarkojë punonjës sipas politikave të shoqërisë;

---



---

të hartojë dhe të nënshkruajë deklaratat tatimore dhe çdo akt tjetër që ka lidhje me dokumentacionin që duhet të dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ose autoriteteve të tjera. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

#### **Neni 9 - Auditimi dhe viti ushtrimor**

9.1 Auditimi Ligjor do të emërohet(n) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në rastet kur kjo është kërkesë e legjislacionit shqiptar. Riemërimi do të bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Auditimi Ligjor mund të shkarkohet me vendim të ortakut të vetëm apo Asamblesë së Ortakëve për shkelje të detyrave, gabime dhe sjelljes jo të mirë profesionale.

9.2 Viti ushtrimor fillon në 01 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përgjithimisht, viti i parë ushtrimor fillon me datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar (QKB) dhe përfundon me datë 31 Dhjetor 2022.

#### **Neni 10 - Shpërndarja dhe Prishja**

10.1 Shoqëria mund të shpërndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Shpërndarja e shoqërisë do të ndiqet nga prishja e saj.

10.2 Shoqëria do të ruajë personalitetin juridik, i cili do të shërbejë për qëllimet e likuidimit dhe emrin e shoqërisë do ta pasojnë fjalët “në proces likuidimi”

10.3 Likudatori(ët) do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Prishja e Shoqërisë dhe emërimi i likuidatorit(ve) do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 11 - Ligji i Zbatueshëm**

11.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me ligjin shqiptar.

11.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar për shoqëritë tregtare.

11.3 Për çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij statuti dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind ndërmjet Shoqërisë dhe palëve të treta, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jenë gjykatat shqiptare.

#### **Neni 12 - Ndryshimet**

12.1 Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ARTO PHARMA SHPK, mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri me

---



---

vendim të ortakut të vetëm apo Asamblesë së Ortakëve. Statuti hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë secila.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

**ARTO PHARMA SHPK**

Marsel Zdrava



---